

Nr. Re nd or	Data e regjistrimit	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përmbajtja e përgjigjes	Mënyra e përfundimit të kërkesës (E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar)	Tarifa e shërbimit
Periudha Janar- Shtator 2023						
1	15.03.2022	Kërkesë për informacion ardhur nga një individ me shkresë, në lidhje me korrespondencën e Departamentit të Administratës Publike me Bashkinë Korçë për lirim të një nëpunësi civil	27.03.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 13.03.2023, protokolluar me tonën nr. 1541, datë 15.03.2023, nëpërmjet së cilës kërkonte të informoheni nëse Bashkia Korçë ka korrespondencë me Departamentin e Administratës Publike në lidhje me praktikën e lirit tuaj nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit, ju bëjmë me dije se:</p> <p>...Në zbatim të pikave 3 dhe 5 të këtij neni, në çdo rast mbylljeje apo ristrukturimi krijohet Komisioni i Ristrukturimit, i cili drejtohet nga njësi përgjegjëse. Komisioni ka për detyrë të shqyrtojë mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vëndet e lira ekzistuese në shërbim civil, si dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike, në përputhje me pikën 2, të nenit 50, të ligjit të sipërcituar. Ndërkohë, referuar shkronjës “F”, të pikës 1, të nenit 4 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, njësi përgjegjëse për njësitë e qeverisjes vendore, si Bashkia Korçë, është njësi e burimeve njerëzore të institucionit. Ndërsa, Departamenti i Administratës Publike është njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, ku përfshihen aparati i Këshillit të Ministrave, ministrinë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit.</p> <p>Në këto kushte, DAP nuk është njësi përgjegjëse për Bashkinë Korçë dhe nuk kemi të administruar korrespondencë me këtë institucion lidhur me praktikën për lirim tuaj nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit.</p> <p>Për sa më sipër, për çdo pretendim apo orientim mbi zbatimin e instituteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, mund t’i drejtoheni Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili mbikëqyr zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.</p> <p style="text-align: center;">Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,</p>	E plotë	Nuk ka

2	21.03.2023	Kërkesë për informacion me email, nga një organizatë, në lidhje me targat e automjeteve ekzistuese në pronësi të Departamentit të Administratës Publike.	29.03.2023	<p style="text-align: center;">Përshëndetje,</p> <p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 21.03.2023, dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), në adresën elektronike info@dap.gov.al, ku bazuar në ligjin nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkonte listën e targave të automjeteve ekzistuese në pronësi të Departamentit të Administratës Publike, ju informojmë se:</p> <p style="text-align: center;">Në nenin 3, të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" parashikohet që:</p> <p>"1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.</p> <p>2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.</p> <p>3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.</p> <p>4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji."</p> <p style="text-align: center;">Për sa më sipër, referuar pikës 2 të kësaj dispozite, ju bëjmë me dije se Departamenti i Administratës Publike nuk ka automjete në pronësi.</p> <p style="text-align: center;">Faleminderit për mirëkuptimin,</p>	E plotë	Nuk ka
3	18.05.2023	Kërkesë për dokumentacion, nga një individ, në lidhje me formularin e vlerësimit të punës të një nëpunësi civil.	31.05.2023	<p>Departamenti i Administratës Publike (DAP) ka administruar kërkesën e z. L. M., protokolluar me tonën nr. 2744, datë 18.05.2023, përmes së cilës kërkon të pajiset me kopje të vlerësimeve të punës për periudhën 2016 – 2019, kohë gjatë së cilës ka qenë i emëruar në pozicionin "Drejtor i Drejtorisë së Marketingut dhe Promocionit", në Agjencinë Kombëtare të Turizmit.</p> <p>Bazuar në pikën 11, të kreut IV, të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë", të ndryshuar, formulari i vlerësimit të punës, i plotësuar dhe i nënshkruar, depozitohet pranë njësisë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në institucion dhe jo pranë DAP-it.</p> <p>Në kushtet sa më sipër, si dhe në mbështetje të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", bashkëlidhur ju përcjellim për trajtim kërkesën e z. M.</p> <p style="text-align: center;">Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,</p>	Dërguar te institucioni që zotëronte dokumentacionin e kërkuar duke vënë në dijeni kërkuesin	Nuk ka

4	26.05.2023	Kërkesë për informacion me shkresë, nga një individ, në lidhje me korresponde ncën dhe procedurën e ndjekur për lirim të detyra, nga detyra, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” .	05.06.2023	<p>Në përgjigje të shkresës suaj të datës 24.05.2023, protokolluar me tonën nr. 2855 prot., datë 26.05.2023, përmes së cilës kërkonte informacion nga ana e Departamentit të Administratës Publike, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar dhe procedurave të parashikuara në kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, DAP realizoi procesin e verifikimit të të dhënave të deklaruara nga ana juaj në formularin e vetëdeklarimit, me institucionet përgjegjëse të përfshira në këtë proces e konkretisht, Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe Prokurorinë e Përgjithshme, e cila me shkresën Nr. 818/44 prot., datë 15.11.2022, përcolli vendimin “Për miratimin e rezultateve të verifikimit”, datë 14.11.2022.</p> <p>Në përfundim të këtij procesi, me shkresën nr. 1694/4 prot., datë 23.11.2023 DAP infomoi Postën Shqiptare Sh.a mbi rezultatet e këtij verifikimi, e cila në vijim me shkresën nr. 481/6 prot., datë 27.01.2023 na bëri me dije se, me Urdhrin nr. 22, datë 18.01.2023, me nr. 112/1 prot., datë 18.01.2023 ju jeni liruar nga detyra e Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse dhe Marketingut, pranë Filialit të Postës Fier, më Postën Shqiptare Sh.a.</p> <p>Për sa i përket kërkesës suaj për vendosjen në dispozicion të dokumentacionit origjinal ose të njësuar me origjinalin, referuar nenit 49, të Kodit të Procedurave Administrative, bashkëlidhur lutemi gjeni kopje të njësuar me origjinalin të shkresës së DAP me nr. 1694/4 prot., datë 23.11.2022 (gjithsej 3 fletë).</p>	E plotë	Nuk ka
---	------------	--	------------	---	---------	--------

5	30.05.2023	Kërkesë për informacion me email, nga një individ, në lidhje me një pozicion të shpallur në faqen e Departamentit të Administratës Publike.	09.06.2023	<p style="text-align: center;">Përshëndetje z. Gjini,</p> <p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 30.05.2023, dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), në adresën elektronike info@dap.gov.al, ku bazuar në ligjin nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkoni informacion në lidhje me, pozicionin e "Jurist në Zyrën e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar, në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit", më poshtë gjeni përgjigjen e Avokaturës së Shtetit, institucioni i cili ka vendin vakant dhe rrjedhimisht disponon edhe informacionin e detajuar për sa keni keni kërkuar:</p> <p>1) Paga e pozicionit "Jurist në Zyrën e Përfaqësimit në Gjykatat Ndërkombetare dhe Arbitrazhin Ndërkombetar" është niveli i pagës III-b.</p> <p>2) Jo nuk ka shtesa.</p> <p>3) Në Shqipëri.</p> <p>4) Jo nuk është ai pozicion që i referohet pikës 9/9 të VKM-së nr. 187, datë 8.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit.", i ndryshuar.</p> <p style="text-align: center;">Faleminderit për mirëkuptimin,</p>	E plotë	Nuk ka
---	------------	---	------------	---	---------	--------

6	07.06.2023	Kërkesë për informacion me shkresë, nga një individ, në lidhje me zbatimin e ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar	13.06.2023	Përgjigja nr.1, bashkëlidhur.	E plotë	Nuk ka
7	13.06.2023	Kërkesë për informacion me shkresë, nga një individ, në lidhje punësimitin e personave me aftësi të kufizuara, në administratën publike.	23.06.2023	Përgjigja nr.2, bashkëlidhur.	E plotë	Nuk ka

8	22.06.2023	Kërkesë për informacion me email, nga një individ, në lidhje me pozicionin e tij aktual si nëpunës civil.	23.06.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 22.06.2023, dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), në adresën elektronike info@dap.gov.al, ku bazuar në ligjin nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkonte informacion në lidhje me pozicionin tuaj aktual si nëpunës civil, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Nga të dhënat e administruara pranë Departamentit të Administratës Publike, rezulton se nëpunësi civil z. A. D., aktualisht mban pozicionin Inspektor i Parë në Sektorin e Kontrollit në Vend sipas Industrive, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj- kategoria e pagës III-b, pozicion në të cilin është transferuar për shkak të ristrukturimit të institucionit, me shkresën nr.2830/130 prot., datë, 15.07.2020 të DAP.</p> <p>Faleminderit për mirëkuptimin,</p>	E plotë	Nuk ka
9	24.07.2023	Kërkesë për informacion me email, nga një individ, në lidhje me një shpallje pranimi në shërbim civil.	02.08.2023	<p>Në vijim të kërkesës suaj për informacion të datës 23.07.2023, protokolluar pranë Departamentit të Administratës Publike me nr. 3909 prot, datë 24.07.2023, bazuar në Kreun III, të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sqarojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Në zbatim të pikës 17, Kreu IV, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", të ndryshuar, njësia përgjegjëse (DAP), në përfundim të procesit të ankimimit për procedurën e pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve me kod #4663- Lloji diplomës "Shkenca Juridike", niveli minimal i diplomës "Master Profesional", njoftoi me email, më datën 14.07.2023, ora 15:15, kandidatët fitues të kësaj shpallje. Bashkëlidhur gjeni një kopje të njoftimit të kandidatëve për procedurën me kod #4663 nga adresa zyrtare e Departamentit të Administratës Publike info@dap.gov.al.</p>	E plotë	Nuk ka

10	22.08.2023	Kërkesë për informacion me email, nga një organizatë, në lidhje me monitorimin e administratës shtetërore në zgjedhjet vendore 2023.	07.09.2023	Përgjigja nr. 3, bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka
11	06.09.2023	Kërkesë për informacion me shkresë, nga një individ, në lidhje me transferimin në përfundim të periudhës së pezullimit	19.09.2023	Përgjigja nr. 4, bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka

12	18.09.2023	Kërkesë për informacion/dokumentacion me shkresë, nga një individ, që kërkon aktin e emërimit të një personi të tretë.	26.09.2023	<p>E nderuar znj. Bataj,</p> <p>Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 16.09.2023, lënda “Kërkesë për dokument”, drejtuar Departamentit të Administratës Publike, me të cilën kërkon që t’ju vihet në dispozicion shkresa nr. 46, datë 06.01.2023, për emërimin e znj. S. T., ju bëjmë me dije për sa më poshtë vijon: Bazuar në Vendimin Nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit”, njësia e burimeve njerëzore në çdo institucion përgjigjet për mbajtjen, plotësimin, sistemimin dhe administrimin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar. Dosja e personelit është individuale dhe ka karakter konfidencial. Për shkak të karakterit konfidencial, të drejtën për t’u njohur me dosjen e personelit, pra me dokumentacionin që ajo përmban, e kanë vetëm personat/institucionet e parashikuara në VKM-në Nr. 833, datë 28.10.2020, të sipërcituar. Një nga dokumentet që përmban dosja e personelit është edhe akti i emërimit në detyrë të nëpunësit civil. Në këtë kuptim, sipas legjislacionit të shërbimit civil, akti i emërimit në detyrë ka karakter konfidencial.</p> <p>Në nenin 63, të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, përcaktohet se ndalohet njohja, shfrytëzimi dhe publikimi i dokumenteve që përmbajnë të dhëna me karakter vetjak dhe çënojnë jetën private të personit. Sipas kësaj dispozite, kur kemi të bëjmë me një akt me karakter vetjak, ndalohet jo vetëm shfrytëzimi dhe publikimi i dokumentit por edhe njohja me të.</p> <p>Gjithashtu, në nenin 3, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, përcaktohet se “e dhënë personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.</p> <p>Ndërsa në nenin 17, të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, parashikohet se një nga rastet kur mund të kufizohet e drejta e informimit është ai kur dhënia e informacionit dëmton të drejtën për një jetë private. Ky kufizim nuk zbatohet vetëm nëse titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës.</p> <p>Për sa më sipër, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, në mungesë të dhënies së pëlqimit nga znj. S. T., Departamenti i Administratës Publike është në kushtet e pamundësisë për t’ju vënë në dispozicion kopje të njësuar të aktit të emërimit Nr. 46 Prot., datë 06.01.2023.</p> <p>Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,</p>	Refuzuar	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	----------	--------

13	21.09.2023	Kërkesë për informacion me shkresë dhe email, nga një individ, në lidhje me disa pozicione në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.	28.09.2023	Përgjigja nr. 5, bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka
14	11.10.2023	Kërkesë për informacion me email në lidhje me statusin e nëpunësit civil të një individi.	17.10.2023	<p>Përsëritje z. H.,</p> <p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 11.10.2023, dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), në adresën elektronike info@dap.gov.al, ku bazuar në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", kërkoni a gëzon statusin e nëpunësit civil znj. Sh. H., ju informojmë se: Nga të dhënat që disponon Departamenti i Administratës Publike, me vendimin nr. 350, data 05.10.2022, Komisioni i Disiplinës i ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ka vendosur: "Për largim nga shërbimi civil të Drejtorit të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara znj. Sh. H."</p> <p>Në nenin 63, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, përcaktohet se:</p> <p>"Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) lirit nga shërbimi civil; b) largimit nga shërbimi civil, si masë disiplinore; c) pranisë së një shkakut të parashikuar nga neni 65 i këtij ligji." <p>Për sa më sipër, referuar gërmës "b", të nenit 63, të sipërcituar, marrëdhënia në shërbimin civil për znj. Sh. H. ka përfunduar me marrjen e masës disiplinore të largimit nga shërbimi civil. Për më tepër, ju bëjmë me dije se kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2023 të DAP-it, me numrin rendor 14, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit". Për çdo kërkesë tuajën për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit të pasqyruar në faqen tonë zyrtare: info@dap.gov.al.</p> <p>Faleminderit për mirëkuptimin,</p> 	E plotë	Nuk ka

15	27.10.2023	Kërkesë për informacion e deleguar për kompetencë nga një institucion tjetër, në lidhje me punësimin e individëve me arsim profesional në administratë publike.	Proces			
16	30.10.2023	Kërkesë për informacion me email nga një gazetar, në lidhje me largimet nga puna të punonjësve në administratë publike.	07.11.2023	Përgjigja nr. 7 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka

17	02.11.2023	Kërkesë për informacion me email nga një individ, në lidhje me nëpunësin më të vjetër në sektor.	16.11.2023	Përgjigja nr. 8 bashkëlidhur	Refuzuar	Nuk ka
18	09.11.2023	Kërkesë për kopje dokumenti me shpresë zyrtare nga një individ	16.11.2023	Dokumenti i dhënë i pasqyruar në përgjigjen nr. 9 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka

19	05.12.2023	Kërkesë për informacion me email nga një individ në lidhje me korrespondencën e DAP për një rast specifik	13.12.2023	<p>Përsëritje, Në përgjigje të email-it tuaj përmes së cilës, referuar ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkoni përcjelljen e korrespondencës shkresore që Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Departamenti i Administratës Publike, kanë pasur në lidhje me kërkesën tuaj për përfundimin e periudhës së pezullimit dhe rikthimin në shërbimin civil, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në nenet 6 dhe 7, të VKM nr.874, datë 29.09.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”, ju bëjmë me dije, si më poshtë vijon:</p> <p>Kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve për vitin 2023 të DAP-it, me numrin rendor 19, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tuajën për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit të pasqyruar në faqen tonë zyrtare: info@dap.gov.al.</p> <p>Në lidhje me kërkesën tuaj sqarojmë se, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me shkresën nr. 16278/1 prot., datë 6.10.2023, ka kërkuar nga ana e Departamentit të Administratës Publike, mendim në lidhje me kërkesën tuaj për përfundimin e periudhës së pezullimit dhe rikthimin në shërbimin civil, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në nenet 6 dhe 7, të VKM nr.874, datë 29.09.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”, për shkak të fushës së përgjegjësisë të pozicioneve që keni mbajtur në administratën doganore.</p> <p>Në përgjigje të shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, nr. 16278/1 prot., datë 6.10.2023, DAP , bazuar në gërmën “f” dhe “dh”, të nenit 42, të po këtij ligji, me shkresën nr. 2952/6 prot., datë 16.10.2023, i ka bërë me dije Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave, që për këshillim për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për verifikimin dhe hetimin administrativ të konfliktit rast pas rasti të interesave, duhet t'i drejtohet Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, në cilësinë e autoritetit qendror përgjegjës.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni të skanuara shkresat e sipërcituara:</p> <p>Shkresa nr. 16278/1 prot., datë 6.10.2023, e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me lëndë "Kërkesë për mendim/ këshillim",</p> <p>Shkresa nr. 2952/6 prot., datë 16.10.2023, e Departamentit të Administratës Publike "Mbi kërkesën për mendim/ këshillim"</p>	E plotë	Nuk ka
----	------------	---	------------	---	---------	--------

20	07.12.2023	Kërkesë për informacion dhe kopje dokumenti me email nga një individ	20.12.2023	Përgjigja nr. 10 bashkëlidhur	E kufizuar	Nuk ka
21	01.12.2023	Kërkesë për informacion me shkresë zyrtare për procedurë ristrukturimi (Kërkesa trajtuar fillimisht nga njësi përkatëse, jashtë objektit të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar)	18.12.2023	Përgjigja nr. 11 bashkëlidhur	E kufizuar	Nuk ka

22	19.12.2023	Kërkesë për informacion me email dhe shkresë zyrtare për procesin e dekriminalizimit	29.12.2023	Përgjigja nr. 12 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka
23	20.12.2023	Kërkesë për informacion me shkresë zyrtare për largimin e një nëpunësi civil anëtar të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues	27.12.2023	Përgjigja nr. 13 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka

24	27.12.2023	Kërkesë për informacion me email e një nëpunësi civil për pozicionin e vetë në shërbim civil.	28.12.2023	<p>Përsëndetje znj. B.,</p> <p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informim, të datës 27.12.2023, Departamenti i Administratës Publike (DAP), ju sqaron si më poshtë vijon:</p> <p>Nga të dhënat që administrojnë DAP, rezulton se aktualisht ju jeni nëpunës civil në pozicionin Inspektor i Parë, në Sektorin e Kontrollit në Vend sipas Industrive, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhënj, kategoria e pagës III-b.</p> <p>Ndërkohë, Administrata Tatimore Qendrore është në proces ristrukturimi në bazë të Urdhrit nr. 69, datë 26.05.2023, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, si dhe Urdhrit nr.189, datë 08.08.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e organigramës së Administratës Tatimore Qendrore”.</p> <p>Referuar nenit 50, të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Kreut II, të VKM nr.125, datë 17.02.2016 "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë", Udhëzimit nr. 1 datë 1.03.2016 "Për krijimin funksionimit dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit", i ndryshuar, Komisioni i Ristrukturimit i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, do të shqyrtojë mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi civil, që preket nga ristrukturimi.</p> <p>Pas administrimit të propozimit nga Komisioni i Ristrukturimit për transferimin e nëpunësve civilë, njësi përgjegjëse (DAP), bazuar në pikën 18 dhe 19 të Udhëzimit nr.1, datë 1.03.2016, të ndryshuar, vendos transferimin e nëpunësit/ve civilë ose kthimin e akteve Komisionit në rastet kur vërteton parregullsi ligjore të dukshme, të cilat kanë ndikuar direkt në vendimmarrje.</p> <p>Në përfundim vendimi i transferimit të përhershëm i njoftohet nga DAP nëpunësit civil që transferohet. Nëpunësi ka të drejtë të refuzojë vendimin dhe të dëgjohet nga njësi përgjegjëse (DAP), brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin, nëse gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pa mundur si dhe kur vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km larg nga vendbanimi i nëpunësit civil.</p> <p>Sa më lart, lidhur me pozicionin tuaj, ju do të njoftoheni në përfundim të procesit të ristrukturimit. Kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2023 të DAP-it, me numrin rendor 24, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tuajën për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit të pasqyruar në faqen tonë zyrtare: info@dap.gov.al.</p>	E plotë	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	---------	--------